



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo Obrazovanja Nauke i
Tehnologije - Ministry of Education, Science and Technology*

Projektligji për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Kuvendi i Republikës së Kosovës,

Në pajtim me nenin 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miratton:

**LIGJIN PËR ARSIMIN E OBLIGUESHËM DHE NIVELIN E KATËRT TË
ARSIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**

HYRJA

**Neni 1.
Përkufizimet**

Në këtë ligj emërtimet e mëposhtme kanë këto kuptime:

1. “Fëmijë” nënkupton personin nën moshën 18 vjeçare.
2. “I rritur” do të thotë çdo person që ka arritur moshën 18 vjeçare, por për qëllim të këtij ligji, përfshin çdo fëmijë që ka arritur moshën në të cilën zakonisht përfundohet arsimi i detyrueshëm dhe është i pranueshëm që të futet në tregun e punës si dhe të marrë pjesë në programet arsimore të përcaktuara për të rritur.
3. ”Arsimimi dhe aftësimi i të rriturve” nënkupton mësimin dhe aftësimin publik dhe privat që ofrohet për të rriturit dhe/ose për fëmijët e moshës mbi 15 vjeç që janë të pranueshëm për të vijuar programet mësimore të përcaktuara për të rriturit.
4. “Zona e mbulimit ” mendohet për zonën e vendbanimit të përcaktuar nga komuna për një shkollë.
5. “Mosha e shkollimit të obligueshëm” për nxënësin nënkupton periudhën e përcaktuar me Nenin 9 të këtij Ligji ?
6. “Kurrikulumi “ nënkupton pjesën e përgjithshme të kurrikulumit të parashikuar nga Ministria për të gjitha shkollat.

7. “Ndëshkimi trupor” do të thotë çdo formë e goditjes ose e kontaktit tjetër fizik jo të rastësishëm nga mësimdhënësit ose ndonjë anëtar i tjetër të personelit me një nxënës, me përjashtim të rasteve të ndërhyrjes së detyrueshme, kur një nxënës rrezikon sigurinë e nxënësve të tjerë ose të personelit.
8. “Drejtor” do të thotë drejtuesi i një institucioni **edukativ- arsimor dhe aftësues**.
9. “ECTS” nënkupton Sistemin evropian për transferim të kredive për arsimin e nivelit universitar.
10. “Institucion **edukativo-arsimor dhe aftësues**” përshin çdo institucion shkollor ose aftësues që realizon shërbime arsimore të niveleve 0, 1, 2,3, 4 sipas ISCED
11. “Shërbime arsimore” do të thotë çdo veprimtari që është drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt e lidhur me mësimdhënien si dhe çdo mbështetje materiale apo ndonjë formë tjetër.
12. “Cikli i parë” nënkupton një program në nivelin 5 të ISCED-së që çon në shkallën Bachelor (180 gjer 240 kredi ECTS).
13. “ISCED” nënkupton Standardet ndërkombëtare të klasifikimit të arsimimit, miratuar nga UNESCO, në Konferencën e përgjithshme, në seancën e 29-të, në nëntor të vitit 1997.
14. “Agjencia e Kosovës për Akreditim” (AKA) nënkupton agjencinë me këtë emër të themeluar me ligj.
15. “Autoriteti kosovar për kurrikulum dhe standarde” nënkupton autoritetin me këtë emër, të themeluar nën dispozitat e këtij ligji.
16. “Korniza e Kurrikulumit të Kosovës” nënkupton kornizën e kurrikulumit, të miratuar nga Ministria, për arsimin **parauniversitar**.
17. “Ministria” nënkupton Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë si autoritet qeveritar kompetent, përgjegjës të e së cilës përfshijnë arsimin, shkencën dhe teknologjinë.
18. “Drejtori komunal i arsimit (DKA)” do të thotë zyrtari në komunë me këtë emërtim ose personi që aktualisht kryen këtë funksion.
19. “Prindi” do të thotë personi që ka kujdesje ligjore për fëmijën në bazë të ligjit përkatës
20. “Shkollë e financuar me fonde publike” nënkupton institucionin edukativo-arsimor i financuar nga fondet publike.
21. “Nxënës” nënkupton çdo person të regjistruar në çfarëdo programi të **arsimit para-universitar**.
22. “Shkollë” do të thotë çdo institucion arsimor që ofron shërbime arsimore në nivelet ISCED 0, 1, 2, dhe 3, përfshirë çdo institucion aftësimi që ofron shërbime arsimore në nivelin ISCED 3.
23. “Kurrikulumi me bazë shkolle” do të thotë ajo pjesë e kurrikulumit që përcaktohet nga vetë shkollat.
24. “Viti shkollor”, do të thotë periudha kohore që fillon më 1 shtator të vitit dhe që përfundon më 31 gusht të vitit pasues, e caktuar nga Ministria siç është përcaktuar në Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës dhe që aplikohet ndaras për shkollat dhe institucionet e aftësimit.
25. “Arsimi i mesëm” nënkupton arsimin e mesëm të ulët dhe atë të lartë nëse nuk është specifikuar ndryshe.
26. “Institucioni i trajnimit” do të thotë çdo institucion, përveç shkollës, i financuar me fonde publike, i cili ofron shërbime arsimore të nivelit ISCED 3 ose 4.
27. “Inspektor i arsimit” është personi zyrtar i Ministrisë i cili merret me inspektimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet e arsimit, të mbuluar me këtë ligj.

28. “Shërbimi pedagogjik në shkollë” nënkupton shërbimet edukativo-arsimore dhe aftësuese të ofruara nga pedagogu, psikologu dhe bibliotekari për përmirësimin dhe avansimin e performancës së shkollës.

Neni 2. Qëllimi i ligjit

1. Qëllimi i këtij ligji është që të rregullojë **edukimin, arsimin dhe aftësimin** parauniversitar.
2. **Ky ligj** vlen për të gjithë fëmijët-nxënësit prej moshës 5 vjeçare derisa të përfundojnë arsimin **parauniversitar**.
3. Qëllimet e kurrikulimit të **edukimit-arsimimit dhe aftësimit** parauniversitar janë:
 - 3.1. Zhvillimi i personalitetit të nxënësit, talentit si dhe aftësisë së tij/saj mendore e fizike në potencialin e tyre të plotë;
 - 3.2. Të zhvillojë te nxënësi respektin për të drejtat e njeriut dhe liritë fundamentale dhe parimet e përcaktuara me Kartën e Kombeve të Bashkuara, Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Fundamentale;
 - 3.3. Të zhvillojë te fëmija-nxënësi respektin për prindërit dhe mësimdhënësit e tij/saj, identitetin kulturor të tij apo të saj, gjuhën dhe vlerat e kombit të tij/saj dhe vlerat e Republikës së Kosovës dhe të komuniteteve të saj;
 - 3.4. Të përgatis nxënësin për jetë të përgjegjshme në shoqëri të lirë, në shpirtin e mirëkuptimit, të paqes, tolerancës, barazisë gjinore dhe miqësisë me të gjithë njerëzit, grupet etnike, kombëtare dhe fetare,
 - 3.5. Të zhvillojë te nxënësi respektin për mjedisin, dhe
 - 3.6. Ta përgatis nxënësin për ndjenjën e përgjegjësisë.

Neni 3. Fushëveprimtaria

1. Është detyrë e përgjithshme e Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve tjera të përfshira në ofrimin **edukimit, arsimit, aftësimit** parauniversitar, siç është rregulluar me këtë ligj dhe ligjet tjera të aplikueshme, për të planifikuar dhe ofruar shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike si dhe të promovojë zhvillimin e tyre arsimor dhe atë social.
2. Gjatë planifikimit, menaxhimit, monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të arsimit parauniversitar, Ministria, komunat dhe institucionet **edukativo-arsimore dhe aftësuese** do të marrin parasysh normat e miratuara ndërkombëtare për arsimin për të gjithë, të drejtat e fëmijës, mbrojtjen e grupeve të cënueshme brenda shoqërisë dhe promovimin e barazisë gjinore.
3. Gjatë zbatimit të funksioneve dhe përgjegjësisive të tyre në kuadër të këtij ligji dhe **ligjeve të tjera** të aplikueshme, Ministria, komunat dhe institucionet arsimore do të:
 - 3.1. Promovojnë mundësitë e barabarta në qasjen në edukim-arsim.

- 3.2. Të respektojnë dhe promovojnë të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre të përcaktuara sipas Kushtetutës.
4. Gjatë ushtrimit të autoritetit dhe detyrave të tyre përkatëse sipas këtij ligji, Ministria dhe komunat respektojnë të drejtat e prindërve për të siguruar **edukim- arsim dhe aftësim** në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, aq sa është në pajtim me ofrimin e mësimdhënies dhe aftësimin efektiv si dhe shmangies së shpenzimeve të panevojshme publike.
5. Qasja dhe përparimi nëpër të gjitha nivelet e **edukimit- arsimit dhe aftësimin** parauniversitar do të mundësohet në pajtim me dispozitat e këtij ligji pa diskriminim direkt apo indirekt në baza ekzistuese ose të supozuara, siç janë: gjinia, raca, paaftësitë fizike, intelektuale ose çfarëdo paaftësie tjetër, gjendja martesore, ngjyra, feja, opinionet politike apo të tjera, përkatësia kombëtare, etnike ose sociale, shoqërimi me ndonjë komunitet, prona, lindja ose ndonjë gjendje tjetër e nxënësit apo familjes së tij.
6. Ministria, komuna dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin edukativo-arsimor atraktiv, tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, arsimtarin dhe prindin.

Neni 4.

Mbrojtja e grupeve të cenueshme

1. Të gjithë personat e punësuar në institucione **edukativo-arsimore dhe aftësuese**, të themeluara sipas këtij ligji, do të ndërmarrin të gjithë hapat e arsyeshëm që të sigurojnë se nxënësit nuk lëndohen, nuk u ekspozohen fjalëve apo veprimeve fyese.
2. Ndalohet ndëshkimi trupor apo çfarëdo forme tjetër e ndëshkimit nënçmues në të gjitha institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese .
3. Ndalohen aktivitetet promovuese për përfitim ose dëmtrim të çfarëdo partie politike, gjinie, me prapavijë racore e etnike, ose gjendjeje sociale nëpër institucionet arsimore. Kur çështjet e tilla ngrihen para nxënësve gjatë punës akademike, nxënësve duhet t'u ofrohet prezantim i balancuar i pikëpamjeve të kundërta.

ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI I SHËRBIMEVE TË EDUKIMIT-ARSIMIT DHE AFTËSIMIT

Neni 5.

Detyrat e Ministrisë

1. Ministria ka detyrat e përgjithshme të poshtëshënuara në lidhje me **edukimin-arsimin dhe aftësimin parauniversitar**, siç janë përcaktuar në këtë ligj:
 - 1.1. Të zhvillojë politika, të hartojë dhe zbatojë legjisllacionin për zhvillimin e **edukimit-arsimit dhe aftësimin** parauniversitar;
 - 1.2. Të promovojë sistem arsimor jodiskriminues në të cilin respektohen të drejtat e secilit person për **edukim-arsim dhe aftësim** dhe ofrohen mundësi të barabarta për arsim cilësor;
 - 1.3. Të sigurojë mbrojtjen e grupeve të cenueshme në kuadër të sistemit të **edukimit-arsimit dhe aftësimin** , të sigurojë shëndetin, sigurinë dhe mirëqenien e nxënësit dhe të të punësuarëve në shkollë.

- 1.4. Krijon kriteret dhe menaxhon një sistem të përgjithshëm të licencimit dhe certifikimit të të gjithë mësimdhënësve;
- 1.5. Të krijojë dhe mirëmbajë një sistem të menaxhimit të informatave në **edukim-arsim dhe aftësim** dhe të nxjerrë kodin e praktikës për komunitat dhe shkollat për të siguruar efikasitetin e sistemit;
- 1.6. Propozon për çdo vit para ministrisë përgjegjëse financimin e buxhetit për **edukimin-arsimin dhe aftësimin** parauniversitar duke përfshirë edhe grantet specifike për komuna, në bazë të të dhënave të ofruara nga sistemi i menaxhimit të informatave në arsim;
- 1.7. Dizajnon, zbaton dhe mbikëqyrë format e paanshme dhe efektive të administratës arsimore dhe menaxhimit të institucioneve **edukativo-arsimore dhe aftësuese**;
- 1.8. Siguron cilësinë, efikasitetin e **edukimit-arsimit dhe aftësimin përmes inspektimit dhe monitorimit**;
- 1.9. **Cakton kriteret e vlerësimit të brendshëm.**
- 1.10. **Organizon dhe menaxhon vlerësimin e jashtëm për nivelet 1, 2 dhe 3.**
- 1.11. Siguron politika gjithëpërfshirëse për integrimin e personave me vështirësi në mësim dhe aftësi të kufizuara .
- 1.12. Promovon pjesëmarrjen e komuniteteve dhe të prindërve në aktivitetet **edukativo-arsimore dhe aftësuese** dhe format e duhura të partneritetit me komunitetin;
- 1.13. Bën inspektim dhe **monitorim periodik dhe të përhershëm të edukimit-arsimit dhe aftësimin**;
- 1.14. Konsulton Sindikatën e Bashkuar të Arsimit dhe Shkencës të Kosovës dhe çfarëdo sindikate tjetër të njohur që përfaqëson kategoritë përkatëse të të punësuarve, për çështjet që kanë të bëjnë me kushtet e punës në institucionet arsimore;
2. Ministria duhet të nxjerrë **akte nënligjore** në lidhje me **kalendarin shkollor** dhe periudhën kohore të vitit shkollor në kuadër të Kornizës së Kurrikulumit të Kosovës, orët e mësimin dhe pushimet, pushimet shkollore, madhësinë maksimale të klasës dhe përpjesëtimin në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve, provimet **dhe llojet e tyre** dhe vlerësimet, në pajtim me legjislacionin në fuqi.
3. Ministria do të nxjerrë **akte nënligjore** në lidhje me regjistrimin, mbajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale në sistemin e arsimit, duke marrë parasysh kriteret në vijim:
 - 3.1. Dokumentet zyrtare të lëshuara nga institucionet e arsimit nuk duhet të përmbajnë të dhëna personale përveç emrit dhe datëlindjes;
 - 3.2. Të dhënat personale që kanë të bëjnë me kombësinë apo statusin fetar mund të evidencohen vetëm për shkaqe të monitorimit statistikor që ndihmon në promovimin e mundësive të barabarta dhe nuk mund të përdoren për ndonjë qëllim tjetër. Të dhënat e tilla nuk mund të regjistrohen në aso mënyre përmes së cilës individët mund të identifikohen si të tillë.
4. **Ministria prezanton raportin vjetor për arsim parauniversitar para Kuvendit, pas përfundimit të çdo viti shkollor.**
5. Ministria emërton dhe riemërton shkollat në bazë të rekomandimit nga DKA përkatëse që duhet të përfshijë gjer në tri propozime të bëra nga organi drejtues i shkollës përkatëse. Ministria emërton dhe riemërton institucionet **edukativo-arsimore dhe aftësuese** të financuara me mjete publike. Çdo institucion edukativo-arsimor do të ketë kodin unik.

6. Kompetencat e Ministrisë në ndërtim të objekteve **edukativo-arsimore dhe aftësuese** përfshijnë:
 - 6.1. Harton standarde dhe normativa për hapësirën shkollore.
 - 6.2. Ofrimin e asistencës teknike për komunat në planifikimin dhe dizajnimin e objekteve edukativo-arsimore dhe aftësuese;
 - 6.3. Financimin dhe aprovimin e ndërtimeve që financohen përmes grantit direkt nga Ministria;
7. Përveç përgjegjësi nga paragrafi (6) i këtij neni, Ministria siguron përshtatshmërinë e ndërtesës shkollore dhe pajisjeve në pajtim me standardet ndërkombëtare të shëndetit, sigurisë dhe mbrojtjes mjedisore, mundësisë së qasjes për nxënësit dhe personelin me aftësi të kufizuara fizike dhe pajisjet ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës;
8. Ministria bën licencimin **institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese**;
9. Ministria vepron si organ i shkallës së dytë për vendimet e organeve tjera **edukativo-arsimore dhe aftësuese** ku e drejta e ankesës është specifikuar në këtë ligj.
10. Ministria me anë të aktit nënligjor mund, për një periudhë kohore të përcaktuar nga ajo, të akordojë lirimin ose zbutjen nga çfarëdo kërkesë të imponuar nga ky ligj cilëndo komunë ose organ drejtues institucional, në mënyrë që të lehtësojë zbatimin e projekteve inovative që, sipas pikëpamjes të Ministrisë, mund të kontribuojnë në ngritjen e standardeve të arsimit që arrihet nga nxënësit. Gjatë ushtrimit të këtij autoriteti, Ministria merr parasysh ndikimin e projektit në planprogramin e strukturuar shkollor dhe gjithashtu duhet të marrë parasysh ndikimin e mundshëm të projektit mbi të gjithë nxënësit që mund të influencohen nga ai projekt.
11. Ministria, me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi, promovon partneritetin publik – privat për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve arsimore.
12. Ministria **nxjerr akte nënligjore për shpërndarjen e teksteve shkollore falas për arsimin e obligueshëm.**
13. **Ministria, me akte nënligjore, përcakton participimin financiar për nivelin e 4.**
14. Ministria, në bashkëpunim me ministritë relevante, ndërmerri masa të veçanta për arsimin e individëve të burgosur ose në institucionet për kundërvajtje për të mitur si dhe për ata të mbyllur në institucione psikiatrike, ose për ata që i nënshtrohen hospitalizimit afatgjatë, në përkujdesje sociale në strehimore dhe për ata që janë liruar nga institucionet ose nga spitalet dhe vazhdojnë arsimin.
15. Ministria mund të nxjerrë **akte nënligjore** në çdo fushë të përgjegjësi të saj **në bazë të këtij ligji.**

Neni 6.

Këshilli shtetëror për arsimim parauniversitar

1. Këshilli shtetëror për arsimim parauniversitar (KSHAP) emërohet nga Ministri.
2. KSHAP është organ këshillëdhënës për Ministrin.
3. Përbërja, puna dhe çështjet administrative që kanë të bëjnë me KSHAP rregullohen **me akt nënligjor.**
4. **KSHAP monitoron, përmes procesit të diskutimit me përfaqësuesit e mësimdhënësve dhe të komunave dhe me ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë, progresin në zbatimin e këtij ligji, përmbajtjen e akteve nënligjore të nxjerra në bazë të këtij ligji dhe çfarëdo çështje tjetër që referohet nga Ministria.**

Neni 7
Kompetencat e komunës

1. **Kompetencat e komunave në fushën e edukimit-arsimit dhe aftësimit janë rregulluar me Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, 21 maj 2008.**

Neni 8.
Edukimi parashkollor

1. **Edukimi parashkollor është rregulluar me Ligjin për edukimin parashkollor nr.02/L-52, 19 janar 2006.**

Neni 9.
Arsimi dhe aftësimi profesional

1. **Arsimi dhe aftësimi profesional rregullohet me Ligjin për arsimin dhe aftësimin profesional nr.02/L-42, 23 shkurt 2006.**

Neni 10.
Arsimi dhe aftësimi për të rritur

1. **Arsimi dhe aftësimi për të rritur është rregulluar me Ligjin për arsimi dhe aftësimi për të rritur, nr.02/L-24, 22 korrik 2005.**

Neni 11.
Inspeksioni i arsimit

1. **Inspeksioni i arsimit është rregulluar me Ligjin për inspeksionin e arsimit në Kosovë, nr.2004/37, 8 shtator 2004.**

SISTEMI I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Neni 12.
Programi i arsimit parauniversitar

1. **Programi për arsimim parashkollor dhe parauniversitar organizohet sipas niveleve të ISCED siç vijon:**
 - 1.1. **Niveli 0: arsimi parashkollor (mosha 0 deri në 6 vjeç), i rregulluar me këtë ligj vetëm për moshën 5-6 vjeçare (klasë parafillore);**

- 1.2. Niveli 1: arsimit fillor (faza e parë e arsimit fillor) për 5 vjet (mosha e zakonshme prej 6 deri 12 vjeç);
- 1.3. Niveli 2: arsimit mesëm i ulët (faza e dytë e arsimit themelor) për 4 vjet (zakonisht prej moshës 12 deri 15); dhe
- 1.4. Niveli 3: arsimit mesëm i lartë për 3 vjet, varësisht nga kurrikulumit i përcaktuar nga Ministria (zakonisht prej moshës 15 deri 18), përfshirë gjimnazin, shkollën e mesme profesionale, shkollën e muzikës dhe atë të artit.
- 1.5. Niveli 4: arsimimi terciar profesional për 1 deri 2 vjet, varësisht nga kurrikulumit i përcaktuar nga Ministria (zakonisht nga mosha 18-20/21).
2. **Edukimi** parafillor, është pa pagesë, për të gjithë fëmijët e moshës pesë (5) vjeçare.
3. Shkollimi i detyrueshëm fillon në fillim të vitit shkollor pas datës kur fëmija arrin moshën 5 vjeçare, mosha minimale për shkollimin e detyrueshëm.
4. Shkollimi i detyrueshëm përfundon me përfundimin e vitit-klasës së dymbëdhjetë.
5. Ministria mund të nxjerrë akte nënligjore për shmangien e situatave jonormale në lidhje me kërkesat e arsimit të obligueshëm.
6. Fëmija i cili është nën minimumin e moshës së duhur për shkollimin e detyrueshëm në fillim të vitit shkollor mund të regjistrohet në nivelin 1, sipas rekomandimit nga mjeku, psikologu dhe mësuesi i kualifikuar. Vendimi për regjistrim merret nga drejtori i shkollës.
7. Ministria, **përmes aktit nënligjor**, mund të specifikojë testet e pranimit për shkolla të caktuara profesionale të nivelit 3.

Neni 13.

Themelimi i institucioneve arsimore

1. Shkollat fillore (niveli 1) dhe të mesme të ulëta (niveli 2) duhet të themelohen në çdo komunë. Shkollat e këtyre niveleve mund të kombinohen.
2. Komuna mund të krijojë dhe mirëmbajë degë ose paralele të ndara të nivelit 1 dhe 2 si pjesë e rrjetit shkollor në zonat në të cilat nuk është praktikë që të themelohet shkolla kryesore, pa shpenzime të paarsyeshme publike, sipas kriterëve të vendosura nga Ministria **me aktin nënligjor**.
3. Arsimimi dhe aftësimi profesional në nivelin 3 mund të bëhet në shkolla apo institucione të aftësimit, publike apo private, ose në ndërmarrje publike apo private. Mund të përshkruhen kërkesa të ndryshme për pranim në kurrikulat e arsimit profesional.
4. Arsimimi terciar profesional në nivelin 4 mund të bëhet në kolegje, institucione të aftësimit, publike apo private, ose në ndërmarrje publike apo private, ose në kuadër të marrëveshjeve për partneritet sipas këtij ligji. Ministria rregullon kushtet për pranim në kurrikulat e ofruara në institucionet e financuara nga fondet publike ose në partneritet me institucionet e shkollimit terciar jouniversitar.

Neni 14

Ndarja e nxënësve nëpër institucionet arsimore

1. Secila shkollë e nivelit 1 dhe 2 duhet të ketë zonën e mbulimit të përcaktuar nga komuna. Të gjithë nxënësit e moshës së shkollimit të detyrueshëm që jetojnë në atë zonë kanë të drejtën e regjistrimit dhe vijimit të shkollës së nivelit përkatës, me kusht

që në rastin e nxënësve me vështirësi në mësim, regjistrimi dhe vijimi vendoset në pajtim me procedurat e përcaktuara **në këtë ligj**.

2. Institucionet edukativo-arsimore **dhe aftësuere** të nivelit 3 kanë zonën e mbulimit të përcaktuar nga Ministria, në bazë të llojit të arsimit dhe aftësimit të kryer.
3. Vijimi në shkollat e akorduara të nivelit përkatës është i detyrueshëm për nxënësit e moshës së shkollimit të detyruar, përveç nëse transferohen në ndonjë shkollë tjetër ose lirohen nga vijueshmëria.
4. Në raste të veçanta, komuna mund të lirojë nxënësit nga vijueshmëria në shkollën e akorduar që është referuar në paragrafin (1) të këtij neni, nëse konstatohet se kjo është në interesin më të mirë të nxënësit, pas kërkesës së bërë nga prindërit e nxënësit dhe sipas dispozitave adekuate alternative të arsimimit në nivelin përkatës.
5. Prindërit e nxënësit që jeton jashtë zonës së mbulimit të shkollës së caktuar mund të aplikojnë në komunën përkatëse për të regjistruar nxënësin në atë shkollë. Vendet e tilla akordohen në mënyrë të drejtë sipas lirisë së veprimit nga komuna në bazë të kriteve transparente dhe të publikuara.
6. **Transferimi i obligueshëm i nxënësit në shkollë kur merren parasysh konsideratat për nxënësit e tjerë, rregullohet me anë të dispozitave të këtij ligji.**
7. Përfshirja e nxënësve në institucionet e aftësimit në nivelin 4 rregullohet **me akt nënligjor**.

Neni 15.

Vijueshmëria në shkollë

1. Prindi i fëmijës së moshës për shkollim të detyrueshëm kryen kundërvajtje, nëse:
 - 1.1. Nuk e regjistron fëmijën në shkollën e cila është shkollë e komunës, institucion aftësimi ose shkollë private e licencuar e përshtatshme për moshën e fëmijës dhe për nivelin e mësimin, ose
 - 1.2. Nuk bën aranzhimet alternative për arsim të fëmijës që janë të aprovuara nga Ministria .
2. Është kundërvajtje për prindin e fëmijës të moshës së shkollimit të detyrueshëm që pa arsye, të përcaktuar si sëmundje ose shkaqe të tjera të pashmangshme, të mos sigurojë vijueshmërinë e rregullt të fëmijës në institucionin arsimor në kohën e përcaktuar nga organi drejtues për fillimin e vitit shkollor.
3. Kur drejtori i institucionit edukativo-arsimor e sheh të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësit, pas marrjes së kërkesës me shkrim nga prindi i nxënësit, drejtori mund të lirojë nxënësin nga vijueshmëria deri në dy javë.
4. Nëse nxënësi pa ndonjë arsye nuk regjistrohet, nuk vijon shkollimin ose e ndërprente arsimin e detyruar, prindërit e tij apo të saj mund të gjobiten nëse mungesa është rezultat i veprimit të paramenduar ose i neglizhencës së prindërve. Në raste të tilla, komuna e njofton Ministrinë me shkrim.
5. Kur komuna nuk ofron, sipas paragrafit (3) të nenit 8, transportin pa pagesë, të sigurt dhe efikas për nxënësit që jetojnë më larg se distanca e shkollës apo institucioni i aftësimit, siç është specifikuar nga Ministria në aktin nënligjor, ose kur nuk është praktike në bazë të sigurisë ose aftësisë së kufizuar të nxënësit që të ecë, prindërit mund të kërkojnë nga Ministria që t'i japë udhëzim relevant komunës dhe komuna të veprojë në bazë të atij udhëzimi.

Neni 16.

Komiteti i prindërve të Kosovës (KPK).

1. Ministria themelon Komitetin e prindërve të Kosovës (KPK). Komiteti ka nëntë (9) anëtarë. Mandati zyrtar është katër (4) vite dhe anëtarët zgjedhin kryesuesin dhe nënkryesuesin e komitetit.
2. Funkzioni i KPK-së është përfaqësimi i interesave të prindërve, t'i dërgojë Ministrisë mendimet për çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar dhe të jetë kanali kryesor i komunikimit dhe konsultimit në mes Ministrisë, institucioneve arsimore dhe prindërve.
3. Ministria **nxjerr akt nënligjor** për punën e KPK-së, përfshirë procedurat për nominimin dhe zgjedhjen e anëtarëve, përfshirë anëtarët nga komunitetet e ndryshme.
4. Ministria siguron buxhetin vjetor dhe infrastrukturën logjistike që të mundësojë punën efektive të funksioneve të KPK-së.
5. Prindërit kanë të drejtë t'i ankohen mësimdhënësit, drejtorit të institucionit arsimor dhe më pas komunës dhe Ministrisë për cilësinë e mësimin dhe ambientin e institucioneve arsimore. Ministria përgatit **akte nënligjore** për shqyrtimin e ankesave të tilla në mënyrë të drejtë.

PËRGJEGJËSITË E INSTITUCIONEVE ARSIMORE

Neni 17.

Organi drejtues

1. Çdo institucion edukativo-arsimor dhe aftësues duhet të ketë organin drejtues. Në rast se organi drejtues nuk mund të formohet ose nuk mund të mblidhet në periudhën prej tre muajsh, funksionet e tij merren nga drejtori i institucionit arsimor, me kusht që komuna (Ministria në rastet e institucioneve të nivelit 4) vazhdon me përpjekjet e mëtutjeshme për t'i themeluar dhe mbajtur takimet çdo 3 muaj.
2. Organi drejtues titullohet **“Bordi drejtues”**.
3. **Bordi drejtues** përbëhet nga:
 - 3.1. **Tre përfaqësues të prindërve, nëse ka minoritete njëri prej tyre duhet të jetë përfaqësues i minoriteteve;**
 - 3.2. **Dy përfaqësues nga komuniteti (palët e interesit);**
 - 3.2. Tre përfaqësues të mësimdhënësve;
 - 3.3. Në rastet e shkollave të nivelit 2 dhe 3, një përfaqësues i nxënësve i zgjedhur nga nxënësit që vijnë shkollimin.
4. Në rastet kur shkollat e nivelit 1-2 ose institucionet arsimore të nivelit 3 kanë më shumë se 1000 nxënës, numri i anëtarëve duhet të ngritet **në katër, dy dhe katër në** kategoritë përkatëse sipas paragrafit (3) të këtij neni. Nëse numri i nxënësve bie nën 1000, anëtarësia duhet të reduktohet në nivelin minimal, ashtu që anëtari që është zgjedhur i fundit në secilin grup kryen mandatin e tij apo saj në fund të vitit shkollor.
5. **Anëtarët e bordit drejtues, nga radha e prindërve**, zgjedhen me votim të fshehtë nga prindërit e nxënësve.
6. **Bordi drejtues** ka të drejtën që të kooptojë përfaqësues plotësues pa të drejtë vote, për të siguruar përfaqësimin e të gjitha komuniteteve që kanë numër të konsiderueshëm të nxënësve në institucionin edukativo- arsimor dhe aftësues dhe të të punësuarve dhe përfaqësuesve të shoqërisë së gjerë.
7. **Mandati i bordit drejtues zgjat tri vjet**, me kusht që ata vazhdojnë të jenë prindër të nxënësve, të jenë mësimdhënës apo nxënës. Përfaqësuesit e prindërve dhe mësimdhënësve mund të zgjedhen për mandatin e dytë.
8. Kryetari i **bordit drejtues** zgjedhet për çdo vit nga **bordi drejtues** prej përfaqësuesve të prindërve. Ai /ajo mund të rizgjedhet.

9. Drejtori i institucionit arsimor është sekretari zyrtar i **bordit drejtues**. Drejtori i raporton organit drejtues për çdo vit për aktivitetet dhe financat institucionale dhe ka të drejtën që të sugjerojë zgjedhje dhe të marrë pjesë në debate, por jo edhe të drejtën e votës. Drejtori i shkollës është përgjegjës për ligjshmërinë e punës së bordit.
10. **Bordi drejtues** i shkollës mund të ftojë drejtorin komunal të arsimit ose zëvendësin e tij/saj që të vijojë takimet e organit drejtues, në mënyrë që të ofrojë informata ose sqarime ose të pranojë pikëpamjet e organit drejtues, por pa të drejtë vote.
11. **Bordi drejtues** i shkollës në nivelet 1, 2 dhe 3, ka detyrat dhe kompetencat si vijon:
 - 11.1. Të hartojë rregulloret e shkollës, që i dorëzohen komunës për aprovim.
 - 11.2. Të zgjedhë një përfaqësues të prindërve dhe një të mësimdhënësve që të marrin pjesë në emërimin e drejtorit, zëvendësdrejtorit, mësimdhënësve të shkollës, në cilësinë e vëzhguesve.
 - 11.3. Të ushtrojë funksionet e tilla në lidhje me shfrytëzimin e buxhetit të shkollës, përfshirë edhe skemën e delegimit në mes komunës, organit drejtues të shkollës dhe drejtorit të shkollës siç janë përcaktuar në këtë ligji.
12. Të vendosë për shfrytëzimin e fondeve që i janë dhënë shkollës si kontribut nga prindërit ose donatorët e tjerë;
13. Të aprovojë aktivitetet shtesë të shkollës jashtë planprogramit, sipas propozimit të drejtorit të shkollës;
14. Të vendosë për kodin e veshmbathjes së stafit dhe të nxënësve;
15. Të shpreh pikëpamjet e tij në çfarëdo çështje që ka të bëjë me shkollën apo çfarëdo aspekti të arsimit parauniversitar;
16. Të aprovojë listën e teksteve shkollë dhe materialeve të tjera shkollë që do të përdoren në shkollë;
17. Të marrë pjesë në formulimin e planeve zhvillimore të arsimit nga komuna, për aq sa ato kanë të bëjnë me ndonjë shkollë konkrete,
18. Të ushtrojë funksionet tjera që i janë deleguar nga komuna në pajtim me ligjin.
19. **Bordi drejtues** i shkollës mban të dhënat e sakta për të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet vjetore dhe në bazë të kërkesës, i vë ato në dispozicion për procedurat e auditimit nga komuna dhe **monitorimit dhe inspektimit nga Ministria**.
20. Organi drejtues i shkollës konsultohet nga komuna ose Ministria, sipas nevojës, për çështjet që kanë të bëjnë me kurrikulin e shkollës ;
21. **Bordi drejtues** i shkollës, me propozimin e drejtorit të shkollës, mund të themelojë organe të tjera konsultative brenda shkollës, ashtu siç konsideron se është e arsyeshme.
22. Anëtarët nga nxënësit në organet drejtuese të shkollës nuk marrin pjesë në asnjë pjesë të takimit e as nuk marrin pjesë në diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me drejtorin, zëvendësdrejtorin, cilindo mësimdhënës apo punëtorë tjetër të shkollës.
23. Nxënësit anëtarë të **Bordit drejtues** të shkollës nuk marrin pjesë në asnjë pjesë të takimit e as nuk marrin pjesë në diskutimet për çështjet që kanë të bëjnë me drejtorin, zëvendësdrejtorin, cilindo mësimdhënës apo punëtorë tjetër të shkollës.
24. Anëtari i **Bordit drejtues** të shkollës nuk merr pjesë në asnjë pjesë të takimit e as nuk merr pjesë në diskutimet për çështjet ku ai apo ajo ka interes personal financiar dhe deklaron interesin e tillë në fillim të takimit.
25. **Bordi drejtues** i shkollës duhet të mbajë regjistrin e interesave personale dhe financiare të anëtarëve të tij dhe të stafit drejtues të shkollës.
26. Për punën apo mospunën e Bordit drejtues përgjegjësia bie mbi drejtorin e shkollës, gjegjësisht mbi drejtorin komunal të arsimit.

Neni 18.
Këshilli i nxënësve

1. Shkollat krijojnë Këshillin e nxënësve i cili përbëhet nga të paktën një nxënës të zgjedhur nga secila klasë, i zgjedhur me votim të fshehtë, për të gjitha shkollat e nivelit 2 dhe 3;
2. Funkzioni i Këshillit të nxënësve është të punojë në përmirësimin e mjedisit mësimor, kushteve të punës dhe interesave që kanë të bëjnë me mirëqenien e nxënësve.

Neni 19
Këshilli i prindërve

1. Komunitetet i zgjedhin Këshillat e prindërve të arsimit.
2. Kompetencat dhe veprimtaria e këshillit përcaktohen me akt nënligjor të veçantë.
3. Shkollat zgjedhin këshillin e prindërve të shkollës.

Neni 20.
Stafi udhëheqës

1. Drejtori dhe zëvendësdrejtori i institucionit edukativo-arsimor ose aftësues emërohen në bazë të Ligjit mbi arsimin në komunitet e Republikës së Kosovës.
2. Kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve përcaktohen me akt nënligjor .

Neni 21.
Sekretari ose administratori

1. Shkollat që kanë më shumë se 500 nxënës kanë të drejtën e zgjedhjes së sekretarit ose administratorit përmes konkursit publik.
2. Zgjedhja, kompetencat dhe përgjegjësitë e sekretarit ose administratorit përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 22.
Rregulloret e shkollave

1. Pas pranimit të propozimeve nga trupi qeverisës i shkollës dhe komenteve nga drejtori i shkollës, komuniteti miraton rregulloret e dizajnuara për të promovuar sjelljen e mirë si dhe disiplinën nga ana e nxënësve.
2. Rregulloret e shkollës i caktojnë të drejtat dhe detyrimet e nxënësve që nuk janë parashikuar në këtë ligj **apo aktet nënligjore** të nxjerra sipas tij, por ato janë të bazuara gjithmonë në **legjislacionin në fuqi**.
3. **Përmbajtja e rregulloreve të shkollave do të rregullohet me akt të veçantë nënligjor.**
4. Nxënësi ose prindi i cili është i pakënaqur me vendimet e komunitetit sipas këtij neni, mund të ankohet në organet kompetente në komunitet dhe nëse prindi është i pakënaqur me vendimin e komunitetit, ai mund të dorëzojë një ankesë në Ministri. Vendimi i Ministrisë do të jetë përfundimtar.

5. **Komuna siguron mësimin alternativ** për arsimimin e nxënësit që është larguar nga shkolla në të cilën nxënësi është transferuar.
6. Komuna mund të udhëzojë organet qeverisëse të shkollës , të marrin masa për evitimin e rrezikut kur, sipas mendimit të organeve të komunës, arsimimi apo siguria e nxënësve në shkollë është ose mund të dëmtohet në një të ardhme të afërt nga aktet e nxënësve apo prindërve .

Neni 23.
Aktivitetet jashtëshkollore

1. Drejtori i shkollës, **me pëlqimin e Bordit drejtues**, mund të organizojë aktivitete jashtëshkollore, ekskursione etj., si dhe të kërkojë prej prindërve që të paguajnë taksën e pjesëmarrjes.
2. Aktivitetet jashtëshkollore rregullohen me **akt të veçantë nënligjor**.

**KURRIKULUMI, TEKSTET SHKOLLORE, MJETET MËSIMORE DHE
STANDARDET**

Neni 24.
Korniza e Kurrikulimit të Kosovës

1. Ministria është përgjegjëse për themelimin dhe zhvillimin progresiv të Kornizës së Kurrikulimit të Kosovës, sipas këshillave nga Autoriteti kosovar për kurrikulum dhe standarde (AKKS).
2. Korniza e Kurrikulimit të Kosovës përbëhet nga një kurrikulum bërthamë dhe kurrikulum me bazë shkolle për secilin nivel të arsimit parauniversitar.
3. Ministria, AKKS, komuna, trupi qeverisës dhe drejtori i një institucioni edukativo-arsimor ushtrojnë funksionet e tyre përkatëse sipas këtij ligji me qëllim që të sigurojnë se Korniza e Kurrikulimit të Kosovës është e balancuar dhe është një kurrikulum i cili :
 - 3.1. **Promovon zhvillimin intelektual, moral, kulturor dhe fizik të nxënësve si dhe shoqërisë; dhe**
 - 3.2. **Përgatitë nxënësit për mundësitë, përgjegjësitë dhe përvojat e mëvonshme jetësore.**
4. Përmes **aktit nënligjor** për secilin nivel të arsimit parauniversitar, Ministria specifikon:
 - 4.1. **Përmbajtjen e kurrikulimit bërthamë, sipas paragrafit (3) të këtij ligji;**
 - 4.2. **Ndarjen e numrit minimal të orëve mësimore për kurrikulumin bërthamë si dhe atë shkolle, duke pasur parasysh se orët e ndara për kurrikulumin me bazë shkolle nuk kalojnë 20 për qind të totalit;**
 - 4.3. **Intervalet dhe metodat e matjes dhe vlerësimit të standardizuar të arritjeve të nxënësve.**
5. Institucionet arsimore, publike dhe private, nuk mund të devijojnë nga kurrikulum bërthamë, përveç në rrethana të veçanta me lejen e Ministrisë, të lëshuar pas konsultimeve me AKKS ose me miratimin e Ministrisë, për projektet inovative.

6. Brenda kurrikulumit me bazë shkolle, institucionet arsimore janë të lira që të mbajnë çdo lëndë e cila nuk është e ndaluar me këtë ligj ose ligje tjera të aplikueshme.
7. Plani i njësive për implementim të kurrikulumit do të miratohet nga drejtori i institucionit edukativo-arsimor.
8. Kurrikulumi bërthamë ose ai me bazë shkolle mund të përfshijnë edhe mbajtjen e lëndëve që përfshijnë kontaktin fizik mes nxënësve dhe personelit ose mes nxënësve. Kontakti i tillë supozohet se është autorizuar nga prindërit e nxënësve nën moshën 18 vjeçare, përveç në rast kur i është dorëzuar drejtorit të shkollës ndalesë me shkrim.

Neni 25.

Autoriteti kosovar për kurrikulum dhe standarde

1. **Ministria emëron Autoritetin kosovar për kurrikulum dhe standarde (AKKS)** nga mesi i ekspertëve të njohur të kësaj fushe.
2. AKKS këshillon Ministrin.
3. **Puna dhe përbërja e AKKS rregullohet me akt nënligjor.**
4. AKKS zhvillon Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës përmes një procesi të rregullt të diskutimit me përfaqësuesit e mësuesve dhe komunës si dhe me ekspertë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfshirë edhe rekomandimet për:
 - 4.1. Përmbytjen e kurrikulumit bërthamë, përfshirë metodologjinë qendrore dhe programet mësimore të lëndëve; objektivat si dhe qëllimin e secilës lëndë që lidhet me fazat kryesore të planprogramit;
 - 4.2. Matjen dhe vlerësimin e standardizuar të arritjeve të nxënësve në intervale të definuara;
 - 4.3. Sistemin konsistent të çertifikimit;
 - 4.4. Listën e teksteve të rekomanduara si dhe burime të tjera mësimore, përfshirë këtu materiale të përshtatshme për përdorim nga nxënësit me vështirësi në mësim.

Neni 26.

Tekstet shkollore dhe mjetet tjera mësimore

1. Ministria miraton tekstet shkollore dhe mjetet tjera mësimore për përdorim në institucionet **edukativo- arsimore dhe aftësuese** sipas këshillave të AKKS.
2. **Trupat qeverisës të institucioneve arsimore miratojnë tekstet shkollore dhe mjetet tjera arsimore të përdorshme në institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese sipas këtij ligji.**

Neni 27.

Kurrikulumi dhe tekstet shkollore në gjuhët e komuniteteve

1. **Kurrikulumi apo tekstet shkollore në gjuhën e komuniteteve do të përdoren siç është përcaktuar në Ligjin për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës.**

SISTEMI I FINANCIMIT

Neni 28. **Financimi**

1. Në bazë të ligjit të aplikueshëm, komunat marrin një grant specifik për arsim që të financojë shpenzimet e sigurimit të nivelit minimal standard të arsimit të detyruar.
2. Granti specifik definohet dhe u ndahet komunave sipas formulës për alokim, të themeluar nga Komisioni i granteve; një formulë e tillë bazohet në regjistrimin e nxënësve si dhe standardet e ofruara nga Ministria. Kjo formulë bazohet kryesisht në numrin e normalizuar të mësuesve dhe regjistrimin efikas. Ajo merr parasysh, gjithashtu, Kornizën e kurrikulumit të Kosovës, nevojat e nxënësve me vështirësi në mësim, shpenzimet operative jashtë pagës, normat e madhësisë së klasës si dhe lokacionin.
3. Referimi për komunën do të jetë i njëjtë me atë të Ministrisë, në rast të institucioneve arsimore të nivelit 4. Kriteret për financimin e institucioneve të nivelit 4 përcaktohen nga Ministria, pas konsultimit me Agjencinë e akreditimit të Kosovës.

Neni 29. **Delegimi i autoritetit financiar**

1. Komunat mund t'ia delegojnë përgjegjësinë për pjesët e specifikuar të buxhetit të komunës për arsim trupave qeverisës të institucioneve arsimore sipas kompetencave të specifikuar në këtë ligj.
2. Nëse përgjegjësia delegohet sipas paragrafit (1) të këtij neni:
 - 2.1. Secili trup qeverisës posedon për secilin vit fiskal një pjesë buxhetore që i është ndarë atij dhe miraton buxhet-planin për institucionin buxhetor;
 - 2.2. Pjesët institucionale të buxhetit do të alokohen sipas formulës së specifikuar në aktin nënligjor;
 - 2.3. Formula e cekur në nën **paragrafin (2.2) të këtij neni** përfshin një dispozitë që amandamenti i pjesëve buxhetore të marrë parasysh ndryshimet në numrin e nxënësve gjatë vitit fiskal;
 - 2.4. Një trup qeverisës institucional mund të delegojë përgjegjësinë për shpenzime në fusha të specifikuar dhe me limite të specifikuar financiare te drejtori i institucionit. Aranzhimet e tilla i nënshtrohen orarit të delegimit të miratuar dhe mund të anulohen nga komuna përkatëse;
 - 2.5. Komuna apo trupi institucional qeverisës ('autoriteti delegues') sigurojnë përpilimin e një dispozite të përshtatshme financiare për personel dhe pajisje për shkarkimin efikas të funksioneve administrative lidhur me buxhetet e deleguara;
 - 2.6. Çdo shumë e siguruar nga komuna për trupin qeverisës institucional mbetet pronë e komunës derisa trupi qeverisës apo drejtori e shpenzojnë atë;
 - 2.7. Çdo pasuri e blerë me fonde nga buxheti i shkollës do të mbetet pronë e komunës dhe do të menaxhohet nga trupi qeverisës institucional apo drejtori, sipas orarit të delegimit;
 - 2.8. Pjesa e miratuar e buxhetit për një institucion arsimor nuk mund të tejkalohej;
 - 2.9. Çdo mospajtim mes trupit qeverisës institucional dhe drejtorit, sa i përket buxhetit të institucionit, i nënshtrohet një arbitrimi obligativ të bërë nga komuna.

Neni 30. **Monitorimi**

1. Sipas ligjit të aplikueshëm, Ministria monitoron dhe siguron se:
 - 2.1. **Komunat zbatojnë grantin special për arsim në pajtueshmëri me ligjegjislacionin në fuqi dhe**
 - 2.2. **Masat që i merr komuna në zbatimin e kësaj fuqie janë ato të duhurat.**
2. Autoritetet deleguese monitorojnë ushtrimin e autoritetit të deleguar.
3. **Autonomia financiare që u jepet trupave qeverisës institucional dhe drejtorëve i nënshtrohet përgjegjësisë së autoritetit delegues në formë të raporteve vjetore të përpiluara për autoritetin delegues.**
4. **Delegimi i autoritetit sipas këtij ligji mund të pezullohet ose anulohet nëse autoriteti delegues e përcakton se fondet janë menaxhuar keq ose janë përdorur për qëllime tjera e jo për ato për të cilat janë deleguar.**
5. Anulimi i autoritetit të deleguar sipas paragrafit (4) të këtij neni ndodh vetëm pas konsultimeve mes palëve dhe përveç rasteve urgjente, kur pandehet se fondet janë keqmenaxhuar, do të kërkohet nga autoriteti delegues që të japë së paku 30 ditë lajmërim për anulimin e planifikuar.
6. Çdo mospajtim mes komunës dhe **Këshillit drejtues** institucional i dërgohet Ministrisë për vendim.

MËSIMDHËNIA DHE STAFI UDHËHEQËS

Neni 31.

Krijimi i bazës profesionale për mësimdhënës

1. **Mësimdhënësit janë persona që kryejnë detyra në institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese sipas legjislacionit në fuqi dhe të cilët përmbushin kushtet e nevojshme të këtij ligji sa u përket kualifikimeve dhe licencimit.**
2. Një person i cili nuk i përmbush kushtet e nevojshme për të qenë mësimdhënës, siç përcaktohet në këtë ligj, mund të punësohet në një institucion **edukativo-arsimore dhe aftësuese** si asistent apo instruktor për të ndihmuar punën e një mësimdhënësi të kualifikuar dhe të licencuar, nëse drejtori i institucionit është i bindur se ky person posedon aftësitë, ekspertizën dhe përvojën e nevojshme për një punë të tillë dhe nuk diskualifikohet nga mbajtja e një pozite të tillë sipas këtij ligji, apo ndonjë ligji tjetër të aplikueshëm.
3. Kriteret për zgjedhjen e asistentëve dhe instruktorëve përcaktohen me **një akt të veçantë nënligjor.**

Neni 32.

Këshilli shtetëror për licencimin e mësimdhënësve

1. Ministri emëron anëtarët e Këshillit shtetëror për licencim e mësimdhënësve (në vijim KSHLM) dhe rregullon procedurat e tij, pagesat dhe çështjet e tjera siç kërkohen me këtë ligj, apo ligje tjera të aplikueshme.
2. KSHLM ka detyra dhe përgjegjësi siç përcaktohen me akte nënligjore.
3. Procedurat zyrtare të KSHLM mbi licencimin dhe marrjen e licencave të mësimdhënësve janë të hapura për inspektim publik.
4. Ministria, **me akte nënligjore**, mund të delegojë një ose më shumë funksione te KSHLM, si dhe mund të anulojë delegime të tilla.

5. Nëse delegimi i funksioneve bëhet sipas paragrafit (4) të këtij neni, Komisioni për ankesa dhe parashtrësia në MASHT do të veprojë si një trup për ankesa ndaj vendimeve relevante të KSHLM.

Neni 33. **Licencimi i mësimitdhënësve**

1. Zhvillimi profesional, vlerësimi i performancës, licencimi dhe kualifikimi dhe rikualifikimi i mësimitdhënësve është përgjegjësi e Ministrisë, e cila vepron sipas këshillave dhe rekomandimeve të KSHLM.
2. Sipas këtij ligji, personat e emëruar apo riemëruar si mësimitdhënës në çdo nivel arsimor kanë kualifikimet profesionale dhe arsimore të ciklit të parë relevant, të miratuar nga Ministria dhe të publikuar **në një akt nënligjor**. Kualifikimet e tilla për të gjitha lëndët përfshijnë një nivel minimal obligativ të trajnimit pedagogjik, të rregulluar sipas programeve të akredituar nga KAA sipas ligjit të aplikueshëm.
3. Sipas rekomandimeve të KSHLM, Ministria mund të specifikojë kualifikime shtesë për mësimitdhënësit e nxënësve me vështirësi në mësim, nxënësve me vështirësi në të parë dhe nxënësve me probleme në dëgjim. Kualifikimet e tilla përcaktohen në **një akt nënligjor**.
4. Personat, të cilët janë nën moshën 50 vjeçare, në datën kur ky ligj do të hyjë në fuqi, të punësuar në institucionet edukativo-arsimore publike dhe private sipas legjislacionit në fuqi si mësimitdhënës të licencuar, por që nuk kanë kualifikimet e kërkuara nga Ministria në paragrafin (2) të këtij neni, do të duhet të ndjekin kurse studimore të miratuar nga Ministria sipas rekomandimeve të KSHLM. Ministria do t'ua anulojë licencën nëse dështojnë të fitojnë kualifikimet e kërkuara deri më 31 gusht 2014.
5. Personat, të cilët janë mbi moshën 50 vjeçare në datën kur ky ligj do të hyjë në fuqi, të punësuar në ndonjë institucion arsimor publik si mësimitdhënës të licencuar sipas legjislacionit ekzistues, por të cilët nuk kanë kualifikimet e kërkuara nga Ministria në paragrafin (2) të këtij neni, do të duhet të ndjekin trajnime të kërkuara nga Ministria sipas rekomandimeve nga KSHLM. Nëse dështojnë të përfundojnë trajnimin brenda një periudhe të arsyeshme, të miratuar nga Ministria, do t'iu merret licenca.
6. Një person i çfarëdo moshe, që posedon kualifikimet e aprovuara profesionale dhe arsimore të specifikuar në paragrafin (2) dhe nëse është e përshtatshme në paragrafin (3) të këtij neni, i cili mban pozitën e mësimitdhënësit me orar të plotë për herë të parë duhet të ndjekë trajnimin induksional që zgjatë 2 vite akademike, dhe gjatë kësaj periudhe do të vlerësohet rregullisht performansa e tij/saj, sipas kritereve të caktuara të KSHLM, nga ana e një mentori mësimitdhënës, i emëruar nga drejtori i institucionit. Pas përfundimit të periudhës së induksionit, bazuar në vlerësimin pozitiv nga mentori, i konfirmuar nga drejtori dhe komuna, mësimitdhënësi do të fitojë licencën e statusit të mësimitdhënësit të kualifikuar (SMK) që jepet me shkrim nga Ministria sipas procedurave të specifikuar në një **akt nënligjor**.
7. Dispozitat e paragrafit (6) të këtij **neni** do të jenë të aplikueshme për ata persona që janë të emëruar në pozita të mësimitdhënësve me orar jo të plotë për herë të parë, përveç riemërimit pas pensionimit si mësimitdhënës i përkohshëm, me periudhën e induksionit që zgjat dy vite të punësimit me orar të plotë.

8. Komuna, mundet, pasiqë të japë arsyet me shkrim për vendimin e saj, të zgjasë periudhën e induksionit të një mësimit deri në një vit shtesë akademik ose periudhë ekuivalente për mësimit me orar jo të plotë.
9. Një person të cilit i është shtyrë periudha e induksionit ose i cili nuk pajtohet me rezultatin e vlerësimit mund të ankohet në KSHLM, i cili mund të vendos t'i rekomandojë Ministrisë që të konfirmojë vendimin e komunës apo të ndalojë vendimin e saj. Vendimi i Ministrisë do të jetë përfundimtar.
10. Rivlerësimi i një mësimit të licencuar, me qëllim të përtëritjes së licencës, do të ndodhë në një interval kohor që nuk kalon pesë vite nga data e përfundimit të periudhës së induksionit, duke pasur parasysh se secili mësimit, i licencuar në datën kur ky ligj do të hyjë në fuqi, do të bëhet më së voni deri më 31 gusht 2014.
11. Rivlerësimi i një arsimtari që mban licencën mund të iniciohet në çdo kohë, nëse puna e mësimit është një çështje për t'u brengosur.
12. Pas marrjes së raportit nga drejtori i institucionit dhe komuna, për rivlerësim sipas paragrafit (10) ose (11) të këtij **neni**, licenca mund të konfirmohet, pezullohet, ose merret nga Ministria sipas rekomandimeve të KSHLM.
13. Një licencë mund të merret apo pezullohet nga Ministria nëse sipas mendimit të saj, bazuar në një raport të përpiluar nga një mjek i pavarur i emëruar nga KSHLM, mësimit nuk është në gjendje të vazhdojë punën për shkak të mungesës së kapaciteteve shëndetësore, fizike apo mentale. Në raste të tilla, mësimit në fjalë do të ketë të drejtën për të paraqitur dëshmi mjekësore dhe të ankohet me shkrim në Ministri. Vendimi i Ministrisë do të jetë përfundimtar.
14. Një licencë mund të merret apo pezullohet nga Ministria me kërkesë të drejtorit komunal të arsimit, atëherë kur procedurat disiplinore janë ndërmarrë kundër një mësimit. Pezullimi do të shqyrtohet pas përfundimit të procedurave të tilla si dhe ndonjë ankese që mund të paraqitet.
15. Licenca tërhiqet menjëherë nga Ministria pas shqiptimit të dënimit për kundërvajtje ose vepra të padenjë që përfshinë fëmijët. Organet e caktuara shtetërore do të lajmërohen për këtë tërheqje sipas ligjit të aplikueshëm.
16. Një person, i cili e ka marrë licencën sipas paragrafit (6) të këtij neni, lë përkohësisht profesionin e mësimit me vullnetin e tij, apo saj mund të rrimërohet pa periudhë induksioni nëse mungesa e tij ose saj është më e shkurtër se pesë vite. Kjo dispozitë nuk është e aplikueshme për mësimit të licencuar sipas legjislacionit të tanishëm, apo për ata persona të shkarkuar nga pozitat e tyre.
17. Të gjithë mësimit të licencuar duhet të ndjekin një trajnim të përshtatshëm për zhvillim profesional, i cili është akredituar nga Ministria sipas rekomandimeve të KSHLM, të publikuar në një **akt nënligjor** dhe zbatohet nga komuna. Asnjë program trajnimi i cili nuk është akredituar nga Ministria nuk do të njihet për këtë qëllim.

Neni 34.

Kualifikimet shtesë për emërim në pozita udhëheqëse, drejtorë komunal të arsimit dhe inspektorë

1. Kandidatët që aplikojnë për pozitën e drejtorit apo zëvendësdrejtorit të një institucioni arsimor, inspektor të arsimit duhet të posedojnë licencën si mësimit të kualifikuar dhe së paku pesë vjet përvojë punë me orar të plotë që nga marrja e licencës 'SMK', apo një statusi ekuivalent, të fituar jashtë Republikës së Kosovës dhe të miratuar nga Ministria, sipas këshillave të KSHLM.

2. Me kërkesë të komunës dhe sipas këshillave të KSHLM, Ministria mund të ndryshojë kushtet e kërkuara në paragrafin (1) të këtij neni në raste të veçanta.
3. Të gjithë drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve edukativo-arsimore, drejtorët komunal të arsimit apo ndonjë person tjetër me përgjegjësi për administrimin apo inspektimin e institucioneve arsimore, që mbajnë pozitat e tyre deri në datën kur do të hyjë ky ligj në fuqi, duhet të kenë përfunduar me sukses deri më 31 korrik 2012 një program kualifikimi profesional për udhëheqësi, administratë ose fusha të ngjashme, i cili duhet të jetë i autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve nga KSHLM.
4. Nga 01 gusht 2012, të gjithë kandidatët për postet e cekura në paragrafin (3) të këtij neni duhet të kenë përfunduar me sukses përpara emërimit të tyre një program kualifikimi profesional për udhëheqje, administrim ose fushë të ngjashme, të cilat janë të autorizuar nga Ministria sipas rekomandimeve të KSHLM, para emërimit të tyre.
5. **Ministria, përmes një akti nënligjor, sipas këshillave të KSHLM**, do të miratojë një program obligativ të vazhdueshëm për zhvillim profesional për personat që mbajnë pozitat e cekura në paragrafin (3) të këtij neni.

Neni 35.

Zgjedhja ose emërimi i drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve, mësimitdhënësve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve dhe instruktorëve

1. Drejtorët dhe zëvendësdrejtorët e institucioneve arsimore, bashkëpunëtorët profesional, mësimitdhënësit, asistentët dhe instruktorët përzgjedhen përmes një konkursi publik në bazë të meritës personale, pa asnjë lloj diskriminimi të drejtpërdrejtë, apo të jodrejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara që kanë lidhje me gjininë, racën, gjendjen civile, përkatësinë etnike, nevojat e veçanta, pasurinë, vendin e lindjes, pikëpamjet politike ose filozofike apo rrethana tjera.
2. Autoritetet që bëjnë emërimet, siç përcaktohet në këtë ligj, krijojnë procedura të drejta, të hapura dhe transparente për angazhim bazuar në kualifikimet dhe nevojat e postit.
3. **Mësimitdhënësit do të emërohen nga një komision i themeluar nga komuna, përfshirë edhe drejtorin e institucionit edukativo-arsimor si dhe përfaqësuesit e Këshillit drejtues.**
4. Kur bëhet përzgjedhja midis një apo më shumë kandidatëve për një post menaxherial ose për mësimitdhënës, **merren për bazë kushtet** si arsimimin e secilit kandidat, përvojën, kualifikimet për pozitë si dhe nevojat që do të plotësojë ky emërim. Nëse asnjëri nga kandidatët nuk i plotëson kushtet për kualifikim të përcaktuar në këtë ligj, mund të bëhet një emërim i përkohshëm. Emërimet e tilla përfundojnë në ditën e fundit të vitit shkollor gjatë të cilit është bërë emërimi.
5. Kontrata e mësimitdhënësit, i cili është emëruar në fillim të semestrit të dytë, vazhdon deri më 31 gusht. Kontrata e një mësimitdhënësi që është emëruar në mars apo më vonë vazhdon deri në fund të vitit shkollor.
6. Asnjë person nuk do të emërohet në një post në një institucion shkollor, publik apo privat, nëse ai ka qenë ndonjëherë i dënuar për krim, dhunë ose vepra të padenja që përfshijnë fëmijët. Një personi që është dënuar për krime të tilla nuk i jepet një pozitë e tillë, apo ai shkarkohet nga posti i tij apo saj menjëherë sipas ligjit relevant të aplikueshëm.
7. Me akt nënligjor, Ministria mund të përpilojë dispozita të tjera në përputhje me këtë ligj për emërimin e drejtorëve, zëvendësdrejtorëve, mësuesve, asistentëve

mësuesve dhe instruktorëve sipas këtë Ligji si dhe përgjegjësitë e komunave dhe trupave qeverisës.

Neni 36.

Mbrojtja nga sanksionet arbitrare

1. Ministria, komunat, trupat qeverisës dhe drejtorët e institucioneve edukativo-arsimore do të sigurojnë se mësimmhënësit kanë liri brenda ligjit si dhe në përputhje me nivelin e arsimit ku janë punësuar, për të vënë në pikëpyetje dhe diskutim njohurinë e fituar si dhe të japin ide të reja dhe mendime të debatueshme dhe jo-popullore brenda planprogramit të miratuar, pa rrezikuar humbjen e vendit të punës apo ndonjë privilegji që mund të kenë.
2. E drejta e mësimmhënësve për liri të shprehjes mund të kufizohet vetëm me ligj.
3. Ministria dhe komunat marrin masa të sigurojnë se :
 - 3.1. Mësimmhënësit kanë të drejtë për organizim dhe mbledhje brenda ligjit; dhe
 - 3.2. Mësimmhënësit janë të mbrojtur nga diskriminimi i drejtpërdrejtë ose jo i drejtpërdrejtë për arsye reale apo të supozuara siç janë gjinia, raca, gjendja civile, ngjyra, religjioni, pikëpamjet politike apo të tjera, origjina kombëtare, etnike, apo sociale, përkatësia ndaj një komuniteti etnik, nevojat e veçanta, pronësia, lindja apo rrethana tjera.

Neni 37.

Personeli profesional jomësimmhënës

1. Personat e kualifikuar sipas standardeve të specifikuara në një **akt nënligjor** mund të zgjedhen nga komuna në institucionet edukativo-arsimore për të ofruar shërbime profesionale, përfshirë: kujdesin mjekësor, mbështetjen pedagogjike-psikologjike si dhe punë këshilluese dhe sociale.
2. **Komuna mund të zgjedhë në institucione arsimore nëpunës, teknikë dhe mbështetës që të marrin funksione administrative, sipas kriterëve të përcaktuara në një akt nënligjor.**
3. Personat e zgjedhur sipas paragrafit (1) ose (2) të këtij neni mund të inkuadrohen në detyra të mësimmhënies vetëm nëse posedojnë licencën.
4. Asnjë person nuk do të zgjedhet në poste, të cilat janë të mbuluar me këtë ligj, në ndonjë institucion arsimor, publik apo privat, nëse ai ka qenë i dënur ndonjëherë për krime të dhunshme ose akte të padenja që përfshijnë fëmijët. Një personit që është dënur për krime të tilla nuk i jepet një pozitë e tillë ose shkarkohet menjëherë nga posti i tij ose saj në përputhje me ligjin relevant të aplikueshëm.

Neni 38.

Emërimet e përkohshme

1. Komuna do të përpilojë dispozitën për pagimin e personave me emërimet të përkohshme si ushtrues detyre i drejtorit të institucioneve **edukativo- arsimore dhe aftësuese**, ose do të sigurojë orë shtesë për të zëvendësuar personelin që mungon për arsye shëndetësore ose të lehonisë.
2. Komuna i obligon shkollat që të kenë orën e kujdestarisë në kuadër të fondit të orëve të mësimmhënësit.

NEVOJAT E VEÇANTA ARSIMORE

Neni 39.

1. Një fëmijë ka vështirësi në mësim nëse:
 - 1.1. Fëmija ka vështirësi dukshëm më të mëdha në mësim se shumica e fëmijëve të asaj moshe;
 - 1.2. Fëmija ka një paaftësi e cila e ndalon ose e pengon që të përfitojë nga mësimdhënia që organizohet në objektet arsimore që ofrohen për fëmijët e moshës së tij, apo saj, në institucionet shkollore.
2. Një fëmijë nuk konsiderohet se ka vështirësi në mësim vetëm për shkak se gjuha, ose forma e gjuhës, në të cilën zhvillohet mësimi nuk është e njëjtë me gjuhën, ose me formën e gjuhës, të cilën e përdor në shtëpi të tij apo saj, ose sepse ai apo ajo i takon një komuniteti të caktuar.
3. Dispozita e veçantë arsimore për një fëmijë do të thotë një dispozitë arsimore që i shtohet, ose dallon nga, dispozita arsimore e bërë në përgjithësi për fëmijët e moshës së tij ose saj në institucionet arsimore të themeluara në komunë, përveç shkollave speciale të rregulluara sipas këtij ligji.
4. Dispozita e veçantë arsimore nuk kufizohet vetëm në fëmijët me vështirësi në mësim, por ajo aplikohet edhe për fëmijët me dhunti të veçanta të cilët mund të kërkojnë modifikim të modeleve normale të progresit përmes sistemit të detyrueshëm arsimor, përfshirë edhe planprogramin.

Neni 40.

Parimi i arsimit gjithëpërfshirës

1. Parimi i arsimit gjithëpërfshirës do të thotë se institucionet arsimore duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa marrë parasysh kushtet e tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore ose kushtet tjera.
2. Komunitat mund të marrin masa për të mbështetur përfshirjen e fëmijëve në shkollat komunale, përfshirë edhe themelimin e dhomave edukative dhe klasës shtesë për fëmijët me dëmtime të ndryshme. Sipas vlerësimeve individuale profesionale për fëmijët me vështirësi në mësim, që ndjekin mësimet në shkollë komunale, komunitat sigurojnë transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm.
3. **Me akt nënligjor do të rregullohet më hollësisht edukimi-arsimi dhe aftësimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.**

Neni 41.

Vlerësimi profesional

1. **Çdo komunë duhet vetë apo në bashkëpunim me komunitat tjera të themelojë ekip vlerësues të përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe rehabilitimit.**
 - 1.1. **Procedura e vlerësimit mund të inicohet me kërkesën e prindërve-kujdestarit ose shkollës me pëlqimin e prindërve.**
2. Vlerësimi profesional shqyrton dhe përcakton çështjet në vijim:

- 2.1. Nëse nxënësi mund të përfitojë nga mësimdhënia e zakonshme;
 - 2.2. Vështirësitë e nxënësit në mësim, aftësitë, interesat si dhe kushte të tjera të veçanta me rëndësi për mësimdhënien;
 - 2.3. Objektivat reale arsimore për nxënësin; dhe
 - 2.4. Çfarë lloji i mësimdhënies është i përshtatshëm, përfshirë pajisjet speciale dhe, nëse është e mundur, të jepet ndihmë për vështirësitë në kuadër të dispozitave normale të arsimit.
3. Ministria, me akt nënligjor, mund të përcaktojë procedurat dhe limitet kohore për vlerësimin profesional.
 4. Nëse vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimin profesional, arsyet për vendimin e komunës shpjegohen me shkrim; prindërve u jepet mundësia të bëjnë një ankesë me shkrim. Në raste të tilla, Ministria do të sjellë vendimin përfundimtar dhe ajo mund të konsultohet me ekspertë të cilët mund t'i zgjedhë vetë.
 5. **Përmbajtja e mësimdhënies për fëmijët me nevoja të veçanta për arsim do të rregullohet me akt nënligjor.**

Neni 42.

Shkollat speciale, qendrat burimore dhe njësitë që ofrojnë arsimim special

1. Ministria mund të themelojë dhe mirëmbajë shkolla speciale, qendra burimore si dhe njësi të tjera që ofrojnë arsim special për fëmijët me dëmtime të rënda ose të shumëfishta, të cilët vlerësohet se nuk janë në gjendje të arsimohen në shkolla.
2. Shkollat, qendrat burimore dhe njësitë e tjera, të themeluara sipas këtij neni, do të ofrojnë, gjithashtu, në kuadër të burimeve që i kanë në dispozicion, ndihmë në bazë të kërkesave të shkollave që arsimojnë nxënësit me vështirësi në mësim.
3. Mësimdhënësit dhe personeli tjetër profesional i punësuar në shkolla, qendra burimore dhe njësi të tjera të themeluara sipas këtij neni licencohen sipas dispozitave të këtij ligji.
4. Komuna siguron transport falas, të sigurt dhe të përshtatshëm apo aranzhon kujdes rezidencial sipas vlerësimit profesional individual për fëmijët që vijnë shkollat speciale, qendrat burimore dhe njësitë e tjera të themeluara në këtë pjesë.

Neni 45.

Gjuha e shenjave dhe Braille

1. Nxënësit dhe fëmijët, të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre amtare, duhet të marrin mësim për përdorimin e gjuhës së shenjave si lëndë dhe lëndët e tjera përmes gjuhës së shenjave.
2. Ministria mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorim të gjuhës së shenjave ofrohet jashtë lokacionit të shkollës ku nxënësit vijnë normalisht mësimet.
3. Nxënësit me shikim të pjesshëm dhe ata të verbër kanë të drejtën për mësimdhënie për përdorim të alfabetit Braille si dhe ndihmën për mjetet e nevojshme teknike.

- Nxënësit e tillë kanë gjithashtu edhe të drejtën për orientimin e nevojshëm dhe për udhëzime gjatë lëvizjes në shkollë, vajtjen dhe kthimin nga shkolla në shtëpi.
4. Para dhënies së mësimiit përmes gjuhës së shenjave, në alfabetin Braille dhe udhëzimeve për orientim dhe lëvizje ose ndonjë trajnimi sipas këtij seksioni, shërbimi këshillimor dhe shëndetësor i komunës, i themeluar sipas këtij ligji, bën një vlerësim profesional mbi të metat e nxënësit si dhe nevojat e tij për qasje.

ARSIMI PRIVAT DHE NË PARTNERITET

Neni 46.

E drejta për arsimim privat dhe për themelim të institucioneve edukativo-arsimore ose aftësuese private

1. Çdo fëmijë-nxënës ka të drejtë të vijojë mësimin në një institucion privat edukativo-arsimor të licencuar sipas këtij ligji.
2. Institucionet **edukativo-arsimore dhe aftësuese private** mund të themelohen nga një subjekt juridik, i cili është regjistruar në Kosovë, apo një qytetar i Republikës së Kosovës.

Neni 47.

Institucionet edukativo-arsimore dhe aftësuese të partneritetit

1. Ministria ose komuna janë kompetente të lidhin kontratë me një institucion ose individ, për të promovuar dhe themeluar **institucione edukativo-arsimore dhe aftësuese me kapital të përzier** sipas ligjislacionit në fuqi.
2. Nëse një institucion themelohet sipas paragrafit (1) të këtij neni, trajtohet si institucion **edukativo-arsimore dhe aftësues me kapital të përzier**.

Neni 48.

Licencimi dhe inspektimi i shkollave private dhe të partneritetit

1. Çdo institucion edukativo-arsimor privat ose partneriteti që ofron arsimim në nivelet 0,1,2,3 dhe 4 duhet **të licencohet nga Ministria si dhe të marrë lejen e punës nga komuna** përkatëse.
2. Kriteret për dhënien e licencës për **edukim-arsim dhe aftësim** formulohen nga Ministria sipas udhëzimeve të **Këshillit kombëtar të kualifikimeve (KKK)** dhe krijojnë një standard licencues qeveritar i cili përcaktohet me **akt nënligjor**.
3. Standardi licencues merr parasysh metoda të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies që përdoren nga institucionet private, përfshirë edhe dispozitat lidhur me:
 - 3.1.Përshtatshmërinë e ndërtesës dhe pajisjeve, të cilat duhet patjetër të jenë sipas standardeve mbi shëndetin, sigurinë dhe që mund të përdoren nga personat dhe nxënësit me dëmtime fizike, përfshirë edhe klasat, kabinetet, trajnimet, laboratorët, fushën ose sallën sportive;
 - 3.2.Bibliotekën dhe dhe sallat për kompjuterë;
 - 3.3.Numrin dhe kualifikimet e mësimdhënësve;
 - 3.4.Kornizën e Kurrikulumit të Kosovës, ose një kurrikule të jashtme, të miratuar nga MASHT-i.

- 3.5. Licenca për një institucion privat edukativo-arsimor përfshin dispozita për garanci bankare për të mbrojtur interesat financiare të nxënësit që të përfundojë arsimimin e tij në një institucion tjetër në rast se ai mbyllet.
4. Një institucion arsimor privat mund të fillojë të funksionojë vetëm pasi të ketë marrë licencën nga Ministria si dhe lejen biznesore nga komuna, mirëpo mund të publikojë shpallje për pranimin e nxënësve gjatë periudhës së dhënies së licencës.
 5. Komunat lëshojnë vetëm licencat biznesore për institucionet private arsimore si edhe për bizneset tjera sipas dispozitave të ligjit të aplikueshëm. Para se t'i japin licencën një institucion privat në territorin e tyre, komunat kërkojnë dëshmi të dokumentuara për regjistrim të biznesit si dhe licencimin nga Ministria si një institucion arsimor.
 6. Procedurat administrative për lëshim, vazhdim dhe amandamentim të licencës përcaktohen me **akt nënligjor**.
 7. Një institucion arsimor privat mundet që në bazë të kontratës me prindër të përcaktojë rregullat e sjelljes së nxënësve.
 8. Themeluesi i një **institucioni edukativo- arsimore dhe aftësues** mund ta mbyllë atë vetëm në përfundim të vitit shkollor.
 9. **Institucioni edukativo- arsimore dhe aftësues** privat i nënshtrohen monitorimit dhe inspektimit nga ana e Ministrisë .
 10. Ministria mund të nxjerrë **akt nënligjor** lidhur me dhënien e shërbimeve private arsimore apo mbështetjes për shërbime të tilla arsimore nga ana e organizatave apo operatorëve joqeveritarë.

Neni 49. **Shkollimi në shtëpi**

1. Nëse komuna mendon se një fëmijë-nxënës i moshës për shkollim të detyrueshëm nga rrethi i saj nuk është duke u arsimuar në mënyrë të duhur, sepse nuk e vijon mësimin rregullisht ose në ndonjë formë tjetër dhe nuk i nënshtrohet përjashtimit të përhershëm sipas këtij ligji, ajo i dërgon një vërejtje prindërve dhe kërkon nga ata që të bindin komunën se fëmija është duke u arsimuar në shtëpi ose diku tjetër brenda periudhës kohore të specifikuar në lajmërim.
2. Arsimimi i duhur sipas paragrafit (1) të këtij neni do të thotë arsimim efikas me orar të plotë që është i përshtatshëm për moshën, aftësitë dhe prirjen e fëmijës si dhe ndonjë nevojë të veçantë për arsim që fëmija mund të ketë.
3. Nëse prindërit dështojnë që t'i përgjigjen komunës brenda kohës së specifikuar në vërejtjen e cekur në paragrafin (1) të këtij neni, komuna e procedon rastin në procedurë për kundervajtje.
4. Nëse prindërit përgjigjen se fëmija është duke u arsimuar jashtë sistemit formal arsimor publik ose privat, aranzhimet e kryera nga prindërit si dhe ato të inspeksionit duhet të autorizohen nga Ministria pas konsultimeve me KKK-në.

Neni 50. **Arsimimi në diasporë**

1. Ministria do të informojë personat përgjegjës për menaxhimin e ndonjë **institucione edukativo- arsimore dhe aftësues** për të cilën aplikohet ky nen për zhvillimet **edukativo- arsimore ose aftësues** në Kosovë në mënyrë të përshtatshme.

2. **Institucionet edukativo- arsimore dhe** aftësues të cilave u atribuohet ky nen janë jashtë vendit dhe të cilat nxënësit që është qytetar i Republikës së Kosovës të moshës për shkollim të detyrueshëm i ofron edukim-arsim dhe aftësim në atë vend, në bazë të mundësive financiare që ka Ministria.

DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 51.

Arsimi i mesëm i lartë

1. Ministria nxjerr akte nënligjore për zbatimin e këtij ligji si dhe për fushat e parregulluara me këtë ligj.
2. Përfshirja e arsimit të mesëm të lartë (niveli 3) në sistemin e arsimit të detyrueshëm hyn në fuqi nga data 1 shtator 2010.
3. Përfshirja e arsimit terciar jouniversitar (niveli 4) në sistemin e arsimit para-universitar hyn në fuqi nga data e cila do të caktohet nga Kuvendi.
4. Komunitet i harmonizojnë rregulloret e aplikueshme me dispozitat e këtij ligji brenda 6 (gjashtë) muajsh nga hyrja e tij në fuqi.

DISPOZITAT SHFUQIZUESE

Neni 52.

1. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji pushojnë së vlejture dispozitat e LAFM si dhe të gjitha dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj.

HYRJA NE FUQI

Neni 53.

Hyrja në fuqi

1. Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. XXX

Data

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës